



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

Nr. 1338/prot.
15

Tiranë më 31.8.2022

Lënda: Mbi dorëzimin e formateve të PBA 2023-2025 (Faza Teknike)

MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, ka përgatitur përmes formateve standarde tabelarë kërkesat buxhetore, në përputhje me Ligjin nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për fazën teknike.

Bashkëlidhur kërkesave buxhetore gjeni relacionin shpjegues.

Konceptoi:  Lindita Morina



KOMISIONERI

Besnik Dervishi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DHE FINANCËS

RELACION

MBI

PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025

FAZA TEKNIKE

Në zbatim të VKM nr. 535, datë 29.07.2022 "*Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025*", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 28.02.2019 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*" si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.22, datë 08.07.2022 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025*", Grupi i Menaxhimit Strategjik në Institucionin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka punuar për rishikimin e kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, Faza teknike (Faza e dytë).

Në prill të vitit 2022, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave 130, datë 02.03.2022, "*Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025*", si dhe akteve administrative për përgatitjen e PBA 2023-2025, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*këtu e në vijim Zyra e Komisionerit ose KDIMDP*), ka përgatitur dhe finalizuar kërkesat e Programit Buxhetor Afatmesëm (projekt buxhetin) për vitet 2023-2025 (Faza Strategjike).

Në funksion të zbatimit të ligjeve, fushë e përgjegjësisë, si dhe për realizimin e detyrave dhe kompetencave gjithnjë në rritje të Zyrës së Komisionerit, është hartuar dhe programuar rritja dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale, e cila ka lindur si nevojë për tu plotësuar, me qëllim që misioni ynë të realizohet në kohë reale dhe në mënyrë dinamike. Misioni ynë mbetet dhënia e garancisë mbi aksesin dhe njohjen e qytetarëve me informacionin publik si dhe përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në veçanti, të drejtën për informim dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale.

Vizioni ynë është të promovojmë një shoqëri që mbështetet në institucione transparente dhe në kontrollues publik/privat të përgjegjshëm, si vlera themelore, me qëllim arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomiko-social. Ai realizohet vetëm duke zgjeruar bashkëpunimin me këta aktorë që standardet dhe normat rregullatore të kthehen në mundësi për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe jo arsye për t'i kufizuar apo për t'u shmangur prej tyre.

Kjo materializohet nëpërmjet qëllimit të programit i cili është: nxitja e përputhshmërisë së sektorit publik dhe privat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit, vendosja e balancës midis dy të drejtave të shtetasve, duke ofruar ekspertizën për ligjbërësit kombëtarë, me qëllim adoptimin e standardeve evropiane në të dyja fushat. Realizimi i mbikqyrjeve/inspektimeve për zbatimin e detyrimeve ligjore, vendosjen e sanksioneve administrative në rastet flagrante të shkeljes së detyrimeve, shqyrtimin e ankesave në lidhje me të drejtën për akses në informacionin publik apo cënimin e privatesisë, në bazë të të cilave Komisioneri ushtron vendimarrjen e tij. Menaxhimi me efektivitet dhe korrektësi i fondeve buxhetore të KDIMDP-së.

Për përmbushjen e sa më sipër, gjatë vitit 2022 dhe në vijim objektivat e Zyrës së Komisionerit do të jenë:

- Mbështetja dhe monitorimi i autoriteteve publike lidhur me vënien në zbatim të Programit të Transparencës së rishikuar dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve;
- Rritja e ndërgjegjësimit të koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe nëpunësve të administratës shtetërore për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe përdorimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve;
- Shtrirja e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve në të gjitha autoritetet publike;
- Ndërmarrja e hapave institucionale dhe ligjorë, me autoritetet përkatëse, në lidhje me adresimin e plotë të kërkesave të pikës 1 të nenit 14 të ligjit për të drejtën e informimit, (trajtimi i kërkesave dhe ankesave për informacion nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania).
- Vijimi i mbikqyrjes së zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit publik dhe privat të sektorëve të veçantë me risk të lartë, duke përgatitur rekomandime unifikues për fushat specifike, për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, të diktuar veçanërisht nga situata e shkaktuar nga përhapja e pandemisë COVID-19;
- Monitorimi dhe mbikqyrja e respektimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga subjektet kontrolluese që ushtrojnë veprimtari tregtimi të drejtpërdrejtë.
- Bashkërendimin institucional me kontrolluesit publik për të vijuar mbikqyrjen dhe monitorimin në funksion të rikuperimit të problematikave të konstatuara në raportin e Zyrës së Komisionerit për mbikqyrjen e kontrolluesve me fokus platformat *online*, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe kontrolluesit publik dhe privat të sektorit të kujdesit shëndetësor;
- Vijimin e kontributit në përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës të BE, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680 (realizimin me sukses të projektit të binjakëzimit që po asiston Zyrën e Komisionerit në këtë kuadër për vitin 2021) duke zbatuar përtej vitit 2021, detyrimet që rrjedhin nga ndryshimi i legjislacionit në këtë fushë.
- Intensifikimi i dhënies së kontributit dhe angazhimit aktiv në grupet ndërkombëtare të punës, në kuadër të Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA), Konferencës

Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA);

- Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuëse, trajnuese dhe promovuese për fushat e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit me qëllim ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve, me fokus nxënësit e arsimit parauniversitar, studentëve, apo përfaqësues të komuniteteve minoritare etnike/kulturore.
- Marrja e masave konkrete në lidhje me thirrjet e pa kërkuara telefonike ose dërgimit të mesazheve me postë elektronike;
- Forcimi i rolit dhe kapaciteteve të koordinatorit të të drejtës për informim;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit në kuadër të harmonizimit të ligjit me *acquis communautaire*;

Si autoritet i pavarur në monitorimin dhe mbikëqyrjen e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit, do të forcojë rolin e saj të pavarur mbikëqyrës në të dy këto shtylla të rëndësishme. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ushtron edhe funksione të tjera në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, monitorimit të sektorëve me sensibilitet të veçantë apo që kanë të bëjnë me aspektet e integritetit dhe mirëqeverisjes, në bazë të kompetencave që i janë dhënë me ligje apo strategji të veçanta, të cilat do të detajohen në brendësi të këtij relacioni.

Hartimi i këtij Projekt-Buxheti (2023-2025), bazohet në analizën e performancës institucionale për vitin 2021 të Zyrës së Komisionerit, pritshmërive për vitin 2022, të parashikuara edhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2021”, detyrimeve që burojnë nga bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe nivelit të plotësimit të indikatorëve, që burojnë nga përfshirja e Zyrës së Komisionerit në strategjitë në nivel kombëtar. Zyrës së Komisionerit i janë shtuar prej vitit 2019, edhe detyrime të tjera për zbatim, të cilat burojnë nga legjislacione vendase por edhe nga detyrimet e legjislacionit të përafuar me *acquis communautaire*, ku forcimi i rolit të saj mbikëqyrës për zbatimin e tyre, do të mund të realizohet me forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe financiare.

Buxheti real për të cilin ka nevojë Zyra e Komisionerit, janë paraqitur në Fazën Strategjike (politikat egzistuese dhe të reja), por për arsye të detyrimeve ligjore, pasqyrat në këtë fazë janë plotësuar sipas formateve të Udhëzimeve të MFE për përgatitjen e PBA-së. Konstatohet se në këtë fazë (VKM nr. 535, datë 29.07.2022 “*Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025*”), janë marrë pjesërisht parasysh kërkesat shtesë (shpenzimet e personelit), por edhe këto jo në proporcion për secilin vit buxhetor 2024-2025. VKM e mësipërme nisur nga të dhënat e MFE-së, ka reflektuar mungesën e financimit në paga e sigurime shoqërore për strukturën aktuale të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 84/2020 “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Kërkesat buxhetore të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konsultohen me elementë të shoqërisë civile, gjatë raportimeve për plotësimin e masave dhe indikatorëve të parashikuara në strategjitë konkrete. Edhe pse të argumentuara drejt, vlerësuar pozitivisht si material edhe nga MFE gjatë analizës buxhetore të fazës së parë (Strategjike) mbi PBA 2023-2025, kërkesat shtesë për mbështetje financiare, kryesisht në shpenzimet operative dhe ato për investime, nuk janë marrë parasysh. Ritheksojmë se mungesa e alokimit të kërkesave shtesë do të kufizojë veprimtarinë institucionale, duke ndikuar negativisht në të gjithë aspektin funksional dhe egzistencial. Paraqitja e dokumentit të PBA 2023-2025 në këtë fazë ka reflektuar rekomandimet modeste të MFE gjatë analizës së PBA-se 2023-2025, por ndërkohë vijon të mbajë të njëjtin qëndrim lidhur me mospërfshirjen dhe plotësimin e PBA-së në sistemin AFMIS. Në mënyrë të vazhdueshme kemi patur komunikime zyrtare por ende nuk është gjetur nga institucionet tuaja përgjegjëse për dixhitalizimin (MFE dhe AKSHI), një mënyrë alternative aksesimi në këtë sistem, në përputhshmëri të plotë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndaj deri në një zgjidhje alternative ligjore do të mbetemi jashtë sistemit AFMIS.

Në formatet e plotësuara respektive, janë përcaktuar objektivet kryesorë institucionale si dhe treguesit e performancës në nivel qëllimi, por dhe në nivel objektivësh, për secilën nga fushat e përgjegjësisë, të rishikuara, referuar analizës së kërkesave buxhetore, të paraqitura në fazën strategjike.

Në këtë fazë, edhe pse në aspektin teknik, kemi paraqitur kërkesat buxhetore sipas politikave ekzistuese brenda tavaneve indikativë të Programit me kosto për produkt dhe sipas artikujve ekonomikë, por ndërkohë riprezantojmë edhe kërkesa shtesë. Edhe pse Udhëzimi i përgatitjes së buxhetit nuk e parashikon në këtë fazë paraqitjen e kërkesave shtesë, Zyra e Komisionerit e konsideron tejet të domosdoshme riparaqitjen e kërkesave për financimin shtesë për politikat ekzistuese (mangësi financimi të strukturës së miratuar si dhe shpenzimet operative), por edhe për prioritetet të lidhura me politikat e reja, si detyrime për tu financuar. Argumentet janë detajuar në fazën strategjike, por edhe të shtuara në këtë fazë, për shkaqe të detajuara në vijimësi të këtij relacioni (shtim i kompetencave të reja dhe pritshmërive të ndryshimeve legjislative, të cilat kanë sjellë rritje pjesërisht të kapaciteteve në burime njerëzore, por të pambuluar me shpenzime financiare). Argumentet janë detajuar në fazën strategjike, por edhe të shtuara në këtë fazë, për shkaqe të detajuara në vijimësi të këtij relacioni.

Zyra e Komisionerit ka arritur nëpërmjet burimeve të saj ekzistuese të realizojë një pjesë të objektivëve dhe indikatorëve të parashikuara por mungesa e fondeve të dedikuara, do të kushtëzojë moszbatimin dhe mosplotësimin e tyre, në vijim.

Përsa më sipër dhe në zbatim të udhëzimeve për hartimin dhe finalizimin e dokumentit të PBA 2023-2025, Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) pas konsultimeve, vendosi të paraqesë kërkesat sipas strukturës dhe formateve të kërkuar.

a. **Formati nr.1** “Misioni i njësisë së qeverisjes qendrore/ Misioni i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”:

Mbrojtja dhe garantimi i dy të drejtave themelore, e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale.

b. Formati nr.2. *“Formati Standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore 2023-2025 për politikat ekzistuese sipas tavanëve”.*

c. Shtojca I-A – *pasqyrat shitesë për buxhetin 2023-2025.*

d. Aneksi –A - Formulari i Propozimit të Projektit të Investimit (FPPI) për disa projekte shitesë.

e) Formatin 2.1 *“Formati Standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore 2023-2025 për politikat ekzistuese, sipas nevojave, përtej tavanëve”*, si dhe kemi vendosur prioritetet për politikat e reja, si detyrime për tu financuar, të përllogaritura në **Formatin .3** *“Formati i përllogaritjes së plotë të kostos së Politikave e reja”*

Në këto formate janë parashikuar objektivet kryesorë institucionale si dhe treguesit e performancës, sipas trendit.

Objektivi kryesor i Zyrës së Komisionerit për Programin Buxhetor Afatmesëm 2023–2025 në kuadër dhe të veprimtarisë së tij është:

- 1- Fuqizimi i funksionit mbikëqyrës/monitorues në funksion të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe ruajtjen e privatësisë, në balancë me të drejtën informimit, duke garantuar qasje në informacion, transparencë dhe llogaridhënie maksimale.

Ky objektivi si dhe aktivitetet/sfidat për tre vitet më pas, janë parashikuar në disa strategji kombëtare (me efektet e tyre financiare) ku më poshtë përmendim:

- 1- Strategjinë Antikorrupsion ku Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit A.1 *“Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion”.*
- 2- Strategjinë për Reformën në Administratën Publike Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e Objektivit 11 *“Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion”.*
- 3- Strategjinë për edukimin ligjor të publikut (SELP) ku Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit IV *“Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës”.*

NË LIDHJE ME KËRKESAT SHITESË PËRTEJ TAVANEVE (POLITIKA EKZISTUESE)

Me Ligjin e Buxhetit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, numri i miratuar i punonjësve është 44, por **shtesa e 5 (pesë) punonjësve nga një vit më parë**, nuk ishte e shoqëruar me reflektimin në fondin e shpenzimeve të personelit për vitin 2022. Mungesa e financimit rezultonte edhe në tavanet e PBA 2023-2025, në fazën paraprake (strategjike). Pas analizës buxhetore Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka marrë në konsideratë kërkesat për mbulimin e financimit të funksionimit të strukturës aktual, ku me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022 janë akorduar fondet për shpenzime personeli për vitin 2022, duke reflektuar fondet shitesë edhe në tavanet përfundimtare për vitin 2023 dhe 2025, por jo në nivelin e mjaftueshëm për vitin 2024.

Për arsye të miratimit të një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, janë shtuar funksionet dhe kompetencat e Zyrës së Komisionerit, të cilat priten të shtohen edhe me miratimin e disa akteve të tjera ligjore në fushën e përgjegjësisë së Zyrës sonë brenda vitit 2022. Për këtë arsye me tonën nr.1006, prot, datë 18.05.2022 kemi paraqitur pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Departamentit të Administratës Publike propozimin për disa shtesa dhe ndryshime në Strukturën e Zyrës së Komisionerit, një strukturë të qëndrueshme dhe efikase, me një numër të shtuar prej 16 punonjësish, shoqëruar kjo me relacionin argumentues mbi krijimin e strukturave të reja apo plotësimin me numrin e nevojshëm të atyre egzistuese. Kjo kërkesë është marrë në konsideratë pjesërisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ku me aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, për Zyrën e Komisionerit është miratuar numri prej 49 punonjësish, pra me një shtesë prej **5 (pesë) punonjësish**, por e pa shoqëruar me efektet financiare për vitin 2022 e për më tej as në tavanet përfundimtare për vitet e PBA 2023-2025.

Ndërsa lidhur me 11 punonjësit e tjerë, do të kërkonim që, pas miratimit të ligjeve specifike, ku sipas pritshmërive do të miratohen brenda vitit 2022, ky numër të përfshihej në miratimin e ligjit për vitin 2023 e ne vijim, duke e shoqëruar edhe me efektet financiare (paga&sigurime&shpenzime operative dhe investime), të llogaritura tashmë në formatet dhe anekset bashkëlidhur këtij relacioni.

NË LIDHJE ME KËRKESAT SHITESË PËRTEJ TAVANEVE (POLITIKA EKZISTUESE)

- 1- Kërkohet shtesë fondesh në Artikullin 600&601 “Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore”, mesatarisht në shumën **7.060 (në mijë) lekë**, për vitin 2023 (shtesat e 5 punonjësve) dhe i përlllogaritur për vitet 2024-2025, detajuar në formatet respektive.
- 2- Fondet për mbulimin e punonjësve me kontratë të përkohshme (6 orë) janë në shumën **2.400 (në mijë) lekë**, të cilat duhet të mbahen në konsideratë nga ana juaj, pasi kërkesat do të vijojnë edhe për vitin 2023-2025 (5 punonjës), me argumentimin e njëjtë si në vitin 2022. Konstatuar dhe rekomanduar nga MFE gjatë analizës Buxhetore 2023-2025 (faza strategjike), fondet përfshihen në kërkesat shtesë për shtim të shpenzimeve operative ose si të shihet më e arsyeshme nga MFE (600&601).
- 3- Artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”, kërkohet rritje për më shumë se 30-40 % më shumë se tavanet e miratuara, në shumën rreth **7.500 (në mijë) lekë** për vitin 2023, si kosto administrative për mbulimin e aktiviteteve të shtuara në veprimtarinë e Zyrës, si pasojë e detyrimeve që burojnë nga përfshirja e Zyrës së Komisionerit në strategjitë kombëtare (të pambuluara nga buxheti) dhe jo vetëm, detajuar në formatet respektive me një trend rritës proporcional për secilin vit buxhetor 2023-2025.

4- Artikulli 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, e cila parashikohet të jetë me një shtesë prej 35.000 (në mijë) lekë mbi tavanet e miratuara, sipas formateve respektive.

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) shihet si një mjet i cili ndryshon jetën e përditshme, transformon organizimin e punës, ndryshon tregjet ekzistuese duke krijuar mundësi dhe modele të reja biznesi, pjesëmarrjeje, bashkëpunimi e ndërveprimi me Administratën Publike, një qeverisje të hapur dhe transparente.

Përdorimi i mjeteve TIK synon lehtësimin e qasjes ndaj informacionit, përmirësimin e proceseve administrative dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në një numër fushash të veprimtarisë së institucionit. Prioritet i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike, investime të cilat renditen sipas prioritarizimit për sa më poshtë:

- **“Blerje pajisje TIK për domein controller të IDI dhe mirëmbajtje”, parashikohet të jetë në shumën 18.000 (në mijë) lekë, për vitin 2023.**

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbime ndaj përdoruesve dhe proceseve të punës. Për të arritur këtë qëllim duhen realizuar objektivat si më poshtë:

- Upgrade i infrastrukturës me Servera të rinj.
- Upgrade i infrastrukturës me Storage për backup.
- Upgrade i infrastrukturës me Sistem për backup.
- Upgrade i infrastrukturës me teknologji të reja për qëllime arkivimi.
- Upgrade i infrastrukturës së rrjetit me pajisje të reja si server, switch dhe Firewall etj.
- Përmirësim i politikave të menaxhimit dhe sigurisë së informacionit.

Blerja e pajisjeve të kërkuara ka si qëllim përmbushjen e këkesave duke përmirësuar infrastrukturen aktuale me anë të këtyre pajisjeve kompjuterike/ TIK. Kjo procedurë do të mundësojë mbarëvajtjen e punës për punonjësit e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu do të garantojë sigurinë e infrastrukturës network në institucion duke integruar modulet e menaxhimit si: Active Directory dhe Domain Controller për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve si dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet teknologjike.

Ky projekt TIK i referohet V.K.M nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar.

- **“Blerje pajisje kompjuterike/elektronike, instrumente/vegla/zyre”, parashikohen të jenë në shumën 3000 (në mijë) lekë, për pajisjen e stafit të ri, me mjetet e punës apo rinovimin e pajisjeve ekzistuese për vitin 2023, ndërsa evidentohet si politikë e re në vitet më pas 2024-2025, sipas formateve respektive.**

Më në detaje argumentimi është dhënë në fishën e plotësuar bashkëngjitur.

- **“Krijimi, zhvillimi, administrimi dhe monitorimi i Regjistrit elektronik të thirrjeve të padëshiruara”**, i cili do të administrohet nga Zyra e Komisionerit, çka nënkupton se çdo ankesë e subjekteve me pretendim të shkeljes së privatësisë do të trajtohet nga Zyra e Komisionerit. Një regjistër i tillë do tu vinte në ndihmë qytetarëve, për garantimin e privatësisë së tyre, nëpërmjet menaxhimit dhe mbikëqyrjes direkte nga Zyra e Komisionerit. Kjo platformë parashikohet të jetë në shumën **11.000 (në mijë) lekë**, e cila është financuar pjesërisht me fond të akorduar 5.500 (në mijë) lekë, por për shkak të vonësave të miratimit të ligjit specifik ky fond parashikohet të mbetet i papërdorur deri në fund të vitit 2022. Kërkohej që fondi i plotë prej 11.000 (në mijë) lekë të financohet në buxhetin shtesë **për vitin 2023**.

Efektet financiare për krijimin e regjistrit të komunikimeve tregtare të pa kërkuara, kanë qenë pjesë përbërëse e relacionit të dërguar në Kuvend, për miratimin e projektligjit *“Për Krijimin e Regjistrit të Komunikimeve Tregtare të pa Kërkuara”*.

- **“Program aplikativ për automatizimin e proceseve të punës të Zyrës së Protokoll/arkivës”**, i cili parashikohet të ketë një kosto prej **3.000 (në mijë) lekë**.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kërkon të ndërtojë një program për automatizimin e proceseve të punës me synim administrimin efektiv të dokumentacionit brenda Institucionit. Zyra e Protokoll-Arkivit, në institucion është përgjegjëse për evidencimin e çdo shkrese, dokumenti apo materiali të ardhur në adresë të institucionit nga të tretët, sipas rregullave në fuqi për arkivat. Të gjitha informacionet dhe mesazhet e ndryshme që hyjnë në Institucion, në formë shkresore, fakse dhe postë eksprese dorëzohen në Zyrën e Protokoll-Arkivit për protokollimin e tyre. Nëpërmjet implementimit të një programi për automatizimin e proceseve të punës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale synon të reduktojë dhe menaxhojë kohën e shqyrtimit të dokumentacionit brenda afateve kohore dhe të rrisë cilësinë në ofrimin e shërbimeve ndaj palëve të treta.

NË LIDHJE ME POLITIKAT E REJA

c) Formati nr.3 “Formati i përlllogaritjes së plotë të kostonë së Politikave të reja”

Në lidhje me politikat e reja (shtesë), ne po ju paraqesim në mënyrë narrative kërkesën mbi efektet financiare për rritjen e kapaciteteve njerëzore-administrative.

Në zbatim të udhëzimit në këtë format janë pasqyruar kostot e produktit/eve në vlerën e plotë reale përtej tavanëve indikative. Gjithashtu janë plotësuar të gjithë elementët e nevojshëm të paraqitjes së kërkesave buxhetore sipas nevojave, ku evidentohet rritja e numrit të punonjësve **prej 11 vetësh**, e cila shkon paralelisht me rritjen e çdo shpenzimi në nivel artikulli, si për shpenzimet korrente dhe ato kapitale administrative.

Prej vitit 2016 e në vijim, Zyra e Komisionerit ka bërë prezent mungesën e kapaciteteve, e cila është evidentuar si problematikë në Raportet e Shtetit të BE-së çdo vit, ku gjatë 5

viteve të fundit kërkohet mbështetja e Zyrës së Komisionerit me rritje kapacitetesh me qëllim garantimin e dy të drejtave kushtetuese që ky institucion mbikëqyr si dhe përgjigjen në mënyrë efektive ndaj sfidave që paraqet përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave. Kemi kërkuar në çdo PBA rritjen kapaciteteve njerëzore, e cila është përmbushur në mënyrë të kufizuar nga viti në vit. Aktualisht Zyrës së Komisionerit i është miratuar numri i punonjësve 49, ku pritet të miratohet struktura konkrete me pozicionet përkatëse.

Në fazën e parë (strategjike) kemi listuar rekomandimet e Progres Raporteve për tre vitet e fundit (2019-2020-2021) ku orientimi ka qenë: Sigurimi i kapaciteteve të mjaftueshme të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave si dhe çdo kompetencë shtesë të shoqëruar me legjislacionin përkatës të miratuar ose të pritshme brenda vitit 2022 si dhe strukturën e propozuar sipas pozicioneve të shtuara apo ndryshuara.

Këto kërkesa janë emergjente, pasi Komisioneri duhet ti përgjigjet nevojës për të realizuar me sukses aktivitetin gjithnjë në rritje dhe të përafruar me aquiss komunitare, që përfshin forcimin e rolit të tij mbikqyrës në të gjithë territorin dhe në fushat tepër specifike/sensitive me risk të lartë, e cila do të mund të realizohet me shtimin e numrit të kontrollesve të mbikëqyrur dhe rritjen e cilësisë së efektivitetit të mbikëqyrjes.

Ndërkohë në këtë format është paraqitur edhe një politikë e re, për të cilën nevojiten shpenzime korrente.

Organizimi i edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) në vitin 2024.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vijon të gëzojë vlerësimin dhe mbështetjen e autoriteteve homologe dhe organizatave ndërkombëtare partnere. Pas suksesit të Konferencës Botërore të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (Global Privacy Assambly-GPA), të mbajtur në Tiranë, më 21-24 tetor 2019, Zyra e Komisionerit është përzgjedhur dhe shpallur organizatore e një tjetër aktiviteti me përmasa botërore: Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (*International Conference of Information Commissioners-ICIC*), edicioni i saj i 15-të. Ky aktivitet parashikohet të zhvillohet në periudhën e pranverës në vitin 2024.

Kjo Konferencë e përvitshme është forumi më i madh në nivel botëror që ndërlidh autoritetet mbikëqyrëse të së drejtës për informim, misioni i së cilës është bashkëveprimi me një zë të vetëm në nivel ndërkombëtar, në funksion të përmirësimit të së drejtës së aksesit të qytetarëve në informacionin/dokumentacionin me karakter publik. Aktualisht, Konferenca numëron 73 autoritete kombëtare/rajonale anëtare, ndërsa përveç shteteve të përfaqësuara, angazhohen fuqimisht aktorë të rëndësishëm në këtë fushë, përfshirë UNESCO-n dhe organizata e rrjete të ndryshme ndërkombëtare.

Zyra e Komisionerit është aktualisht, anëtare e organit drejtues të kësaj Konference, Komitetit Ekzekutiv të ICIC, e zgjedhur me një mandat 3-vjeçar, që nga maji 2021.

Organizimi i këtij aktiviteti të nivelit botëror është një vlerësim i rolit, kontributit dhe kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit për përmirësimin e kulturës së transparencës dhe mirëqeverisjes në vendin tonë. Zhvillimi i kësaj Konferënce pritet të ndikojë akoma edhe më shumë në rritjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike në Shqipëri, ashtu si edhe në rajonin tonë, ku theksojmë, se ajo nuk është zhvilluar asnjë herë më parë. Nga ana tjetër, për mbarëvajtjen e një aktiviteti të këtyre përmasave dhe në nivel sa më të lartë, në frymën e Konferencës Botërore të Mbrojtjes së të Dhënave 2019, GMS evidenton kërkesën për mbështetjen me fonde nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vitet 2023-2024, për të cilën ndërkohë ka venë në dijeni dhe ka kërkuar edhe mbështetjen e institucioneve më të rëndësishme të vendit tonë. Bashkëlidhur ju ftojme të gjeni letrën zyrtare të konfirmimit të organizatorit të ICIC-së në 2024, nga ana e Presidentes së Komitetit Ekzekutiv të ICIC.

Autoriteti ynë nisur edhe nga eksperiencia dhe situacioni i shpenzimeve të Konferencës Botërore të vitit 2019, kërkon mbështetjen buxhetore, me rreth **10.000 (në mijë) lekë**, fond i cili duhet të parashikohet të alokohet në dy vite 2023-2024, për ti paraprirë shpenzimeve të nevojshme, ndërsa do të vijohet edhe me kontributin e donatorëve/sponsorëve për mbulimin e mjaft shërbimeve. Kosto totale financiare, sipas informacioneve të siguruara nga vendet organizatore, parashikohet të jetë mbi këtë shifër.

Efektet financiare shtesë përsa argumentohen bindshëm për vitet 2023-2025 paraqiten si më poshtë:

- 1- Kërkohet shtesë fondesh në Artikullin 600&601 **“Shpenzimet për pagat dhe sigurime shoqërore & shëndetësore”**, në shumën **15.900 (në mijë) lekë**, për një numër punonjësish të shtuar **11 vetë**, i njëjtë për çdo vit buxhetor 2023-2025.
- 2- **Artikulli 602, “Mallra dhe shërbime të tjera”**, parashikohet të jetë në shumën **13.000 (në mijë) lekë, për vitin 2023** si kosto administrative në proporcion me numrin e shtuar të punonjësve e për rrjedhojë dhe për mbulimin e aktiviteteve të shtuara, dhe shpenzimeve paraprake gjatë vitit 2023 për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare të argumentuara më lart si dhe përkatësisht **11.000 (në mijë) lekë për vitin 2024** si dhe **10.000 (në mijë) lekë për vitin 2025**.
- 3- **Artikulli 231 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”**, parashikohet të jetë sipas prioritarizimit dhe për vite buxhetore për sa e si më poshtë:
 - **“Blerje pajisje kompjuterike/elektronike, instrumente/vegla/zyre”**, parashikohen të jenë në shumën **3000 (në mijë) lekë**, për pajisjen e stafit të ri, me mjetet e punës apo rinovimin e pajisjeve ekzistuese për vitin **2023** dhe i detajuar më tej për vitin **2024 në shumën 4.000 (në mijë) lekë**, si dhe në vitin 2025 në shumën 3.000 (nëse realizohen kërkesat e vitit 2023-2024).

- **“Regjistri i subjekteve kontrollues (Mbrojtja e të dhënave)”**, i cili parashikohet të jetë në shumën **3.500 (në mijë) lekë**, pa përfshirë edhe koston e mirëmbajtjes së tij, shërbim i cili do të financohet nga shpenzimet operative të një viti me pas. Platforma parashikohet të financohet me fondet e **vitet 2023**.

Njoftimi, është një proces me anën e të cilit kontrolluesit e të dhënave personale njoftojnë Zyrën e Komisionerit në lidhje me të dhënat që ata përpunojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Ky informacion i dhënë nga kontrolluesit, i parashtruar gjatë plotësimit të rubrikave të “Formularit të Njoftimit”, aktualisht pasqyrohen nga Zyra e Komisionerit në një Regjistër Elektronik të Kontrolluesve, i cili është i hapur për publikun në faqen zyrtare www.idp.al, por për shkak të viteve të përdorimit (2010) dhe ndryshimeve ligjore, e humbur efektivitetin e tij. Zyra e Komisionerit parashikon të ndërtojë një sistem informatik për regjistrimin e subjekteve kontrolluese duke mundësuar menaxhim të plotë të subjekteve kontrolluese, plotësimin e formularit brenda një kohe më të shkurtër dhe shkurtimin e kohës së punës të punonjësve gjatë fazës së monitorimit dhe raportimit. Për çdo ndryshim në qëllimin apo qëllimet e përpunimit, si dhe në përmbytjen e njoftimit të mëparshëm, çdo subjekt kontrollues i regjistruar duhet të njoftojë sërish Zyrën e Komisionerit.

- **“Dixhitalizimi i Programit të Transparencës ”**, i cili parashikohet të jetë në shumën **3.500 (në mijë) lekë**, pa përfshirë edhe koston e mirëmbajtjes së tij, shërbim i cili do të financohet nga shpenzimet operative të një viti më pas. Platforma parashikohet të financohet me **fondet e vitit 2024**.

Qëllimi i kësaj platforme është: Përmirësimi i procesit të ruajtjes, procesimit, monitorimit dhe raportimit të Programit të Transparencës për të gjitha institucionet publike duke rritur transparencën dhe besueshmërinë. Institucioni do të ndërtojë një sistem informatik për të patur një database të qendëruar e cila do të lejojë ruajtjen, aksesimin, monitorimin dhe raportimin për të gjitha institucionet publike të cilat janë të detyruara ligjërisht të plotësojnë programin e transparencës.

Programi i transparencës do të plotësohet elektronikisht nga të gjitha institucionet duke krijuar një bazë të dhënash solide dhe duke reduktuar kohë gjatë procesit të monitorimit dhe raportimit.

- **“Shtimi i funksionaliteteve të Regjistrimit elektronik të kërkesave për informacion”**, i cili parashikohet të jetë në shumën **2.500 (në mijë) lekë**, pa përfshirë edhe koston e mirëmbajtjes së tij, shërbim i cili do të financohet nga shpenzimet operative të një viti më pas. Platforma e shtuar parashikohet të financohet me **fondet e vitit 2025**.

Sistemi elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit i ofron mundësinë çdo qytetari apo/dhe çdo grup interesi të mund të dërgojnë në mënyrë të thjeshtë elektronike kërkesat pranë Institucioneve shtetërore përgjegjëse si edhe mund të dërgojë ankesa në rast refuzimi të informacionit të kërkuar pranë. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale synon të shtojë funksionalitetet e sistemit duke lejuar trajtimin dhe ndjekjen e procedurës së ankesave në

koordinim dhe me institucionet e tjera nëpërmjet sistemit. Aktualisht ankesat rregjistrohen në sistem nga palët e interesuara, qytetarë apo organizata dhe trajtohen nga inspektorët pranë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndërkohë që institucioni për të cilin është dërguar ankesa nuk ka akses në rastin e ankesës së raportuar.

Në formë tabelare paraqesim efektet financiare të kërkesave shtesë përtej tavaneve, si për politikat egzistuese ashtu dhe të reja, për çdo zë shpenzimi,

në mijë lekë

EMËRTIMI	KËRKESAT SHITESË POLITIKAT EKZISTUESE			
	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	TOTALI për tre vite
Shp. Paga e Sig. Shoq.	7.060	11.175	7.200	25.435
Shp. të tjera korrente	7.500	10.265	10.765	28.530
Shp. të tjera korrente (punonjës me kontratë)	2.400	2.400	2.400	7.200
Shp.kapitale të brendshme	35.000	0	0	35.000
Totali	51.960	23.840	20.365	96.165

në mijë lekë

EMËRTIMI	KËRKESAT SHITESË POLITIKAT E REJA			
	VITI 2023	VITI 2024	VITI 2025	TOTALI
Shp. Paga e Sig. Shoq.	15.900	15.900	15.900	47.700
Shp. të tjera korrente	13.000	11.000	10.000	34.000
Shp.kapitale të brendshme	6.500	7500	5.500	19.500
Totali	35.400	34.400	31.400	101.200

TOTALI I KËRKESAVE PËRTEJ TAVANEVE (POLITIKAT EGZISTUESE DHE SHITESË)

EMËRTIMI	KËRKESAT SHITESË POLITIKAT E REJA +EGZISTUESE			
	VITI 20223	VITI 2024	VITI 2025	TOTALI
Shp. Paga e Sig. Shoq.	22.960	27.075	23.100	73.135
Shp. të tjera korrente	20.500	21.265	20.765	62.530
Shp. të tjera korrente (punonjës me kontratë)	2.400	2.400	2.400	7.200
Shp.kapitale të brendshme	41.500	7.500	5.500	54.500
Totali	87.360	58.240	51.765	197.365

Nëpërmjet këtij projekt buxheti, do të kërkonim të vlerësonit me prioritet kërkesat për fondet shtesë, për politikat egzistuese dhe ato të reja, pasi tavanet e shpenzimeve për

KDIMDP-në, për të tre vitet e PBA-së, 2023-2025, miratuar me VKM nr. 535, datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, janë të pamjaftueshme krahasimisht me kërkesat reale dhe jo në proporcion me aktivitetet e shtuara edhe në aspektin ndërkombëtar.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



Konceptoi: Lindita Morina

Aneksi 5.A
F2 - Formulari i Propozimit te Projektit te Investimit (FPPI)
01. Personat e Kontaktit

Institucioni Buxhetor	Komisioneri për te Drejten e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale	Departamenti	Drejtoria e Shërbimeve të brendshme dhe financës
Emri dhe pozicioni i propozuesit te projektit	Besnik Dervishi Komisioner	Detajet e kontaktit te propozuesin e projektit (tel, email)	Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nr.5, Tirana, Albania. Phone: + 355 4 2237200 Fax: + 355 4 2233977 Email :info @idp.al
Personi i kontaktit Buxhet & Finance	Lindita Morina Drejtoe e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës	Detajet e kontaktit te Buxhet & Finance	Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nr.5, Tirana, Albania. Phone: + 355 4 2237200 Fax: + 355 4 2233977 Email: Lindita.morina @idp.al

02. Identifikimi i Investimit

Ministria/groupi/sektori (Institucioni buxhetor)	1089001	Kodi i Grupit	89
Emri i Programit	Planifikim menaxhim administrim	Kodi i Programit	1110
Emri i Projektit	Blerje dhe rinovim pajisjeve kompjuterike/instrumente/vegla/pajisje zyre, për nevojat Zyrës së KDIMDP-së Politike e re	Kodi i Projektit	18 AC102
		Numri i identifikimit nga DMIP	
		Vendodhja e Projektit	
Statusi i Projektit	I ri 0 Ne <input checked="" type="text" value="X"/> vazhdim	Financimi nga Donatori (nqs ka)	Buxheti i shtetit
Data e Fillimit	2023	Data e	2025

03. Justifikimi i Investimit

Problemet e gjendjes aktuale që duhen adresuar/ Justifikimi i nevojës për investime

Infrastruktura aktuale është e përbërë prej rreth nga 40 kompjutera, laptop, 2 servera , 2 rutera dhe 4 printera dhe ose te tjera pajisje e mobilime sipas nevojave. Serverat shërbejnë për ruajtje të dhënash, mail server. Pajisjet kompjuterike komunikojnë midis tyre nëpërmjet rrjetit fizik të brendshëm (lokal), kemi të instaluar softë për komunikim të brendshëm e të jashtëm. Do të pajiset stafi me setet e nevojshme të standartizuara të punës (tavolina, etazher, karrige etj)

Një pjesë e kompjuterat apo pajisjet e tjera, të cilat janë në shërbim të stafit, janë prokuruar me fondet e vitit 2010, të cilat për shkak të kohëzgjatjes, kane dale jashte perdorimit de jane asgjesuar, ka të tjera që tashmë ndodhen jashtë kushteve të punës, kanë ngadalësuar shpejtësinë PC/IT), nuk përshaten me teknologjinë e re në fushën e IT, si dhe me fluksin e madh të punës gjithnjë në rritje, sjellin edhe ngadalësimin e proceseve administrative. Edhe pse janë riparuar pas shfaqjes se problemeve, pajisjet kompjuterike tashmë kanë arritur edhe vlerën totale të amortizimit, të akumuluar në vite (2010-2020), duke bërë të pamundur përdorimin. Ato kane dalë jashtë përdorimit. Nderkohe po pergatitet edhe dalja dhe asgjesimi i nje pjese tjeter te pajisjeve IT (te cilave ju ka kaluar koha e vitetve te perdorimit dhe jo vetem /amortizuar dhe nuk jane ne gjendje pune) por nje pejse tjeter mund te kaloje kalim kapital ne institucione tetjera si ato arsimore per klasat eksperimentale. Një pjesë e pajisjeve IT, janë rinovuar me fondet e shtuara prej vitit 2020 por edhe nga te ardhurat e krijuara , duke plotësuar relativisht nevojat e punonjësve aktuale të vitit 2020.

Pajisje për zyrat e reja (sete të kompletuara për stafin egzistues dhe atë të ri : poltrona, tavolina, sirtariere, etazhere etj mobileri apo pajisje të përshtatura per stafin eshtuar per vitin 2021 dhe ate te pritshmin e vitit 2022)m

Me fondet e vitit 2020-2021, u plotesuan me pajisje mobilerie apo dhe te tjera pajisje efektive, ndërsa një pjesë e pajisjeve dhe mobilerise ekzistuese, të cilat nuk u adoptuan me ambjentet e reja, u ndoq procedura e tjetërsimit të aktiveve të qëndrueshme u rivlerësuan dhe dhuruan institucioneve të tjera të administratës publike, por dhe per shkak te amortizimit dhe kushteve/ gjendjes së tyre u asgjesuan me procedurë.

